



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KESHILLI I PAVARUR MBIKEQYRES PER SHERBIMIN CIVIL TE KOSOVES
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUZBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Pamblenjo/Prodato Received/Delivered	20.01.2023	3	viti god year
Organ /Hjesia Organ /Jedinteca Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa e Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SILOMSTICK	605/2023		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KESHILLI I PAVARUR MBIKEQYRES PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.Nr.1047/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Çlirim Zeka -Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit. ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1047/2022 të datës 23.11.2022 të parashtruar nga ankuesi _____, me përfaqësues të autorizuar adresa rr."Rexhep Luci" H-29 nr.9 Prishtinë, kundër Komunës së Prishtinës, në çështjen juridike "Kontestim Konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 si dhe neni 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 i Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 19.01.2023, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar me ankesën me numër A.nr.1047/2022 të datës 23.11.2022 të parashtruar nga ankuesi _____

A r s y e t i m

Ankuesi _____ më datë 23.11.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 7399/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës kundër heshtjes administrative dhe shkeljes së dispozitave ligjore për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës konform dispozitave Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 13.12.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Prishtinës. Më datë 28.12.2022 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Prishtinës me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 27.12.2022 ka nxjerr Vendim VK.nr.196/2022 me të cilin ka bërë zgjatjen e afatit për vendosjen e ankesës së ankuesit për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit me numër protokolli 7399/2022 të datës 23.11.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Plotësim i Dokumentacionit (Ankesës) me numër protokolli 7628/2022 i datës 05.12.2022; Vendim i datës 30.11.2022; Autorizim nga ... I për avokate ... i datës 20.11.2022; Kopje e letërnjoftimit e ...; Konkurs me numër reference RN00009309 i datës 29.06.2022; Certifikatë nga Gjykata për ... e datës 27.06.2022; Vërtetim për ... i datës 12.07.2022; Formular për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike për Kategoritë Drejtues i Mesëm, i Ulët dhe Profesional për ... i datës 29.01.2021; Formular për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike për Kategoritë Drejtues i Mesëm, i Ulët dhe Profesional për ... i datës 31.01.2022; Diplomë me numër 401 e datës 22.10.2019; Diplomë me numër 201 e datës 10.11.2005; Vërtetim për ... i datës 28.06.2022; Certifikatë për ... nga Gjykata e datës 27.06.2022; Akt Emërim i ... me numër 112-882 i datës 01.08.2016; Akt Emërim i ... me numër 01-112-882 i datës 05.04.2013; Vërtetim për ... i datës 06.02.2015; Vërtetim për ... i datës 10.02.2021; Certifikatë për ... datës 21.03-01.04.2011; Certifikatë për ... datës 07-18.03.2011; Certifikatë për ... e datës prill 2017; Licencë nga Ministria e Infrastrukturës për ... e datës 26.02.2021; Licencë nga Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit për ... e datës 09.02.2019; Rekomandim për ... i datës 09.03.2010; Referencë për ... i datës 09.03.2010; Vërtetim për ... i datës 20.05.2004; Vërtetim për ... i datës 01.06.2004; Dëftesë për Pranimin e Dërgesës e datës 22.09.2022; Formular për kërkesë apo ankesë me numër protokolli 14-070/01-0207024/22 e datës 26/10/2022; Ankesën e ankuesit me numër protokolli 14-070/01-207024/22 e datës 27.09.2022; Njoftim për intervistë e cila do të mbahet me datë 22.08.2022; Rezultatet përfundimtare të verifikimit paraprak e datës 04.08.2022; Njoftim nga Simbnj për ... I i datës 20.09.2022; Njoftim i datës 26.09.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë nga ... për ... e datës 15.11.2022; Dëftesë për Pranimin e Dërgesës e datës 22.09.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë me numër protokolli 7992/2022 e datës 13.12.2022; Përgjigje në kërkesë me numër protokolli 8526/2022 e datës 28.12.2022; Akt Emërim i M. H me numër 112-882 e datës 18.08.2016; E-mail nga ... për ...; Njoftim i Komisionit Vlerësues i datës 31.11.2022; Renditja përfundimtare e kandidatëve nga SIMBNJ; Njoftim i Komisionit Vlerësues i datës 26.09.2022; Njoftim i Komisionit Vlerësues i datës 04.08.2022; Njoftim nga sektori i Burimeve Njerëzore i datës 26.07.2022; Vendim nga sektori i Burimeve Njerëzore i datës 12.07.2022; Akt Emërim i H. B me numër 112-1075 i datës 19.11.2019; Akt Emërim i ... me numër 01-112-1054 i datës 01.12.2022; Akt Emërim i ... me numër 01-112-1126 i datës 01.03.2022; Akt Emërim i ... me numër 112-997 i datës 10.03.2017; Akt Emërim i ... me numër 01-112-1126 i datës 03.12.2021; Njoftim i Burimeve Njerëzore i datës 19.08.2022; Njoftim i Burimeve Njerëzore i datës 19.08.2022; Njoftim i Burimeve Njerëzore i datës 19.08.2022; Pliko me numër R2569195; Ankesë me numër 14-070/01-207024/22 e datës 26.09.2022; Njoftim nga Simbnj për ... i datës 20.09.2022; Formular për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike për Kategoritë Drejtues i Mesëm, i Ulët dhe Profesional për ... i datës 29.01.2021; Formular për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike për Kategoritë Drejtues i Mesëm, i Ulët dhe Profesional për ... i datës 29.01.2021; Certifikatë nga Institute of transportation engineers për ... i datës 01.04.2011; Certifikatë nga Institute of transportation engineers për ... i datës 18.03.2011; Certifikatë nga Oda Ekonomike e Kosovës për ... muajt Prill 2017; Licencë nga Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit për ... e datës 09.02.2019; Rekomandim për ... i datës 09.03.2010; Referencë nga hidroterm për ... i datës 09.03.2010;

Vërtetim nga nptsh. Drenica për i datës 20.05.2004; Vërtetim nga shpk. Treafiko për i datës 01.06.2004; Vërtetim nga Komuna e Prishtinës për i datës 10.02.2021; Vërtetim nga Komuna e Prishtinës për i datës 05.02.2015; Formular për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike për Kategoritë Drejtues i Mesëm, i Ulët dhe Profesional për i datës 29.01.2021; Formular për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike për Kategoritë Drejtues i Mesëm, i Ulët dhe Profesional për i datës 31.01.2022; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës Hasan Prishtina për me numer 397 i datës 07.10.2019; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës Hasan Prishtina për me numër 641 i datës 23.11.2015; Diplomë e shkollës së mesme Gjimnazi i Filologji "Eqrem Çabej" i datës 06.07.2012; Licencë nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për i datës 12.06.2021; Certifikatë nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për me numër 251/2021 e muajit Qershor 2021; Certifikat nga MASHT për i datës 21.03.2016; Licencë nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për i datës 19.05.2021; Certifikat nga The cambridge school për e muajit shtator 2010; Certifikat nga The cambridge school për e muajit shkurt 2010; Certifikat nga The cambridge school për e muajit mars 2009; E-mail nga L.C.D. për i datës 27.12.2022; Certifikata nga The cambridge school për e muajit mars 2011; Vërtetim nga Komuna e Prishtinës për i datës 01.07.2022; Leternjoftim i; Patent shofer i; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës e me numër 201 i datës 10.11.2005; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës Hasan Prishtina për me numër 401 i datës 22.10.2019; Akt Emërim i i datës 13.02.2013; Akt Emërim i i datës 01.08.2016; Vërtetim nga Komuna e Prishtinës për i datës 28.06.2022; Akt Emërim i i datës 01.08.2016; Vërtetim nga Komuna e Prishtinës për i datës 10.02.2021; Vërtetim nga Komuna e Prishtinës për i datës 05.02.2015; Leternjoftime i; Formular për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike për Kategoritë Drejtues i Mesëm, i Ulët dhe Profesional për i datës 29.01.2021; Formular për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike për Kategoritë Drejtues i Mesëm, i Ulët dhe Profesional për i datës 31.01.2022; Vërtetim nga Komuna e Prishtinës për i datës 12.07.2022; E-mail nga për i datës 16.01.2023; Njoftim i datës 06.01.2023; Vendim me numër VK.nr.196/2022 i datës 27.12.2022;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara si nga ankuesi ashtu edhe nga organi i punësimit, ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit Menduh Halili, *është bërë i pamundur, sepse:*

Nga administrimi i provave materiale, Kolegji ka gjetur se Komuna e Prishtinës më datë 29.06.2022 ka publikuar njoftimin për hapje të konkursit për lëvizje brenda kategorisë me numër reference RN00009309 për pozitën e punës "Zyrtar i Lartë për Komunikacion Rrugor" në Drejtorinë e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, për aplikim nga data 14.04.2022 deri me datë 21.07.2022 në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi. Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Prishtinës në fazën e shqyrtimit paraprak me datë 26.07.2022 ka shpallur Njoftimin përmes të cilit është bërë njoftimi se ankuesi ka kaluar fazën e verifikimit paraprak dhe se i njëjti do të vazhdoj me procedurën e intervistës me gojë.

Më tej, nga shkresat e lëndës rezulton se Komisioni Vlerësues për Lëvizje Brenda Kategorisë sipas Renditjes Përfundimtare të Kandidatëve të datës ka vlerësuar kandidatët me pikët e fituara për pozitën "Zyrtar i Lartë për Komunikacioni Rrugor" në Komunën e Prishtinës ku kandidati Menduh Halili nuk ka arritur të merr pikët e kërkuara për të qenë kandidat fitues dhe i njëjti është renditur i dyti (2) me gjithsej 40 pikë ndërsa kandidati fitues Shefki Beqiri gjithsej ka grumbulluar 85 pikë i cili është renditur i pari si kandidatë.

Ankuesi kundër vlerësimit të Komisionit Vlerësues për Lëvizje Brenda Kategorisë ka parashtruar ankesë me datë 26.09.2022 në Komisionin e Vlerësimit për Lëvizje brenda Kategorisë, ndërsa ky i fundit nuk i ka kthyer përgjigje.

Ankuesi me date 23.11.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës kundër heshtjes administrative dhe shkeljes së dispozitave ligjore për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale lidhur me konkursin e zhvilluar nga Komuna e Prishtinës ku ka kërkuar të aprovoj ne tërësi ankesën e ankuesit dhe te përzgjedh ankuesin si kandidat fitues ose te anuloj në tersi konkursin për lëvizje brenda kategorisë me numër reference RN00009309 për pozitën e punës "Zyrtar i Lartë për Komunikacion Rrugor" në Drejtorinë e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave.

Ankuesi me date 05.12.2022 ka bere plotësimin e ankesës së datës 23.11.2022, ku ka kontestuar Vendimin e datës 30.11.2022 me te cilin e ka refuzuar ankesën e ankuesit te datës 26.09.2022 me arsyetimin se Komisioni i Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë, në intervistimin me gojë ka vlerësuar se kandidati që ka aplikuar për pozitën e lartcekur nuk i ka arritur pikët e mjaftueshme për përzgjedhje gjegjësisht nuk ka arritur pikët për të qenë kandidat fitues.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave me datë 16.01.2023 ka pranuar emalin zyrtar nga Zyrtarja e Lartë e Personelit e Komunës së Prishtinës me të cilin Këshilli është njoftuar se me datë 06.01.2023 Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës se Prishtinës ka publikuar njoftimin nga për anulimin e konkursit të datës 29.06.2022 për lëvizje brenda kategorisë me numër reference RN00009309 për pozitën e punës "Zyrtar i Lartë për Komunikacion Rrugor" në Drejtorinë e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, në Komunën e Prishtinës, me arsyetimin se kandidati i përzgjedhur ka refuzuar emërimin për këtë pozitë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në rrethanat e lartcekura, konstaton se meqenëse Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Prishtinës me datë 06.01.2023 ka publikuar Njoftimin për anulimin e konkursit të datës 29.06.2022 për lëvizje brenda kategorisë me numër reference RN00009309 për pozitën e punës "Zyrtar i Lartë për Komunikacion Rrugor" në Drejtorinë e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, i cili ka qenë edhe pretendim i ankuesit, atëherë Kolegji konsideron që objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit është bërë i pamundur apo i kotë sepse me këtë rast pretendimi i ankuesit është përmbushur apo realizuar, dhe mbi këtë bazë nuk ka me objekt shqyrtimi gjegjësisht objekti i lëndës është bërë i pamundur, ashtu siç përcaktohet me dispozitat ligjore të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenin 104 i cili thekson se: *"Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë"*, andaj ne rastin konkret Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se janë plotësuar

kushtet për përfundimin e procedimit administrativ të iniciuar me ankesën e datës 23.11.2022 të parashtruar nga ankuesi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe sipas nenit 103 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.


KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1047/2022

Çlirim Zeka

Procesmbajtës



Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.